



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 84, datë 30.07.2019

**PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË ZNJ. VALBONA BALA (PAJO) NË VENDIN
VAKANT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA
KUVENDI NË DATËN 12.02.2018**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

| | |
|-------------------------|-----------------------------|
| Ardian Dvorani | - Kryetar |
| Vitore Tusha | - Zëvendëskryetare/Relatore |
| Arta Marku | - Anëtare |
| Margarita Buhali | - Anëtare |
| Fatjona Memçaj | - Anëtare |
| Fatri Islamaj | - Anëtar |
| Eriol Roshi | - Anëtar |

Asistuar nga sekretare **Ermelinda Kadiu**,

Me praninë e **Avokates së Popullit, znj. Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës,

në mbledhjen e datës **30.07.2019**, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATE PËR GJYQTARE

NË GJYKATËN KUSHTETUESE: Znj. Valbona Bala (Pajo)

OBJEKTI:

Urdhërimi i ndalimit të kandidimit të znj. Valbona Bala (Pajo), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoji relatimin e anëtares së Këshillit, **znj. Vitore Tusha**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/c të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, Kuvendi, në datën 12.02.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të ish-gjyqtarit Vladimir Kristo.

2. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të Ligjit nr. 8577/2000.

3. Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe znj. Valbona Bala (Pajo).

4. Në zbatim të nenit 125 dhe 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577/2000, të neneve 229, pika 2 e nenit 234, 235, 236, 237, 239 e 240 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 98 të aktit nënligjor normativ, Vendimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbledhjen e zhvilluar në datën 05.04.2019, vendosi fillimin e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes të kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.

5. Në zbatim të nenit 228 të Ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 05.04.2019, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për secilin nga vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018, relatore për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, znj. Vitore Tusha.

7. Znj. Valbona Bala (Pajo), si njëra ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidatja Valbona Bala (Pajo), gjendet e administruar në dosjen e kandidatës.

8. Në datën 09.04.2019, kandidatja Valbona Bala (Pajo) është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatës të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidatës.

9. Në datën 12.04.2019, kandidatja Valbona Bala (Pajo) ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidatës.

10. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 265 prot, datë 19.04.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr.115/2016.

11. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidatja Valbona Bala (Pajo), ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

12. Me shkresën nr. 2854/4 prot, datë 03.05.2019, ILDKPKI ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se kandidatja Valbona Bala (Pajo) e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të Ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

13. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr. 9/28 prot., datë 27.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Valbona Bala (Pajo) dhe personat e lidhur me të.

14. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, edhe ky Këshill ka kryer veprimet verifikuese të kërimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatës Valbona Bala (Pajo) dhe personave të lidhur me të.

15. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatës Valbona Bala (Pajo), Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 17.04.2019, i është drejtuar me kërkesa për informacion institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si vijon:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Kreditit e Shqipërisë, (6) Banka e Parë e Investimeve, (7) Banka Intesa Sanpaolo, (8) Banka Kombëtare Tregtare, (9) Banka Ndërkombëtare Tregtare, (10) Banka Procredit, (11) Banka Raiffeisen, (12) Banka Societe Generale, (13) Banka Tirana dhe (14) Banka Union.
- b) Institucioneve financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë : (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k. (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Shoqëria e Parë Financiare e Zhvillimit – FAF, (15) Tirana Factoring & Lease, (16) Tranzit sha, (17) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekteve financiare të licencuar nga AMF : (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit ËVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike si : (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

16. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara në pikën 15 më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidaten Valbona Bala.

17. Në lidhje me rezultatet e kontrollit të ushtruar dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI, në datën 28.05.2019, Këshilli ka njoftuar në rrugë elektronike kandidaten Valbona Bala (Pajo) për të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje, si edhe të depozitojë çdo dokument justifikues që ajo disponon.

18. Kandidatja Valbona Bala (Pajo), në datën 03.06.2019 dhe në datën 15.07.2019 në rrugë elektronike, ka dhënë shpjegimet përkatëse duke bashkëlidhur edhe dokumentacion shtesë justifikues.

19. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr.110 prot., datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar sipas ligjit nr. 138/2015 nga kandidatja Valbona Bala (Pajo).

20. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1134/197 prot., datë 28.05.2019, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Valbona Bala (Pajo).

21. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidates Valbona Bala (Pajo), në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i është drejtuar më kërkesë për informacion Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr.120 prot., datë 17.04.2019*), Shërbimit Informativ të Shtetit (*shkresa nr.114 prot., datë 17.04.2019*), Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (*shkresa nr.118 prot., datë 17.04.2019*) dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr.117 prot., datë 17.04.2019*).

22. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vijim të procedurës së sipërcituar për verifikimin e integritetit, me shkresën nr.352 prot., datë 20.05.2019, i është drejtuar Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar të kërkuar pranë institucioneve përkatëse ligjzbatuese për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve.

23. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë dërguar përgjigjet e tyre, përkatësisht me shkresat *nr.1545 prot., datë 10.06.2019* dhe *nr.680/1 prot., datë 15.05.2019*, mbi të dhënat e kërkuara për të gjithë kandidatët, përfshirë edhe kandidaten Valbona Bala.

24. Në vijim të procedurave të verifikimit dhe kontrollit të integritetit, në zbatim të nenit 229 dhe 236 të Ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, me shkresën nr. 112 prot., datë 17.04.2019, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nr. 45/2015 nga kandidatja Valbona Bala (Pajo) për kompetencë dhe shqyrtim pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

25. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr.551/1 prot., datë 03.05.2019 ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Valbona Bala (Pajo).

26. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91/93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli ka marrë në shqyrtim dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidatja Valbona Bala (Pajo) në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

27. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, Këshilli në datën 02.05.2019 i është drejtuar më kërkesë për informacion partive politike, si dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (*shkresa nr. 270 prot., datë 19.04.2019*), duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë. Në përgjigje të këtyre kërkesave, KQZ dhe parti politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidaten Valbona Bala (Pajo).

28. Gjithashtu, për këtë rast kandidimi, lidhur me kushtin e parashikuar nga shkronja “d” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi*, me shkresën *nr.268 prot, datë 19.04.2019*, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për informacion Gjykatës Kushtetuese, pranë të cilit kandidatja Valbona Bala (Pajo) ka ushtruar dhe vijon ushtrimin e funksioneve publike, për të dërguar të dhëna nëse ka pasur dhe ka masa disiplinore ndaj kësaj kandidateje.

29. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr.144/1 prot., datë 23.04.2019.

30. Me shkresën nr. 925/17 prot., datë 25.07.2019, Kolegji i Posaçëm i Apelit i ka përcjellë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vendimin (me arsyetim të përmbledhur) (JR) nr. 17 datë 25.07.2019, me të cilin Kolegji i Posaçëm i Apelit ka vendosur:

“Ndryshimin e vendimit nr. 65 datë 13.09.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit si më poshtë:

*Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e vlerësimit Valbona Bala (Pajo)
Subjekti i rivlerësimit Valbona Bala (Pajo) nuk mund të emërohet gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15 vjeçare.
Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.”.*

31. Nisur nga rrethanat faktike dhe ligjore të sipërcituara, në gjendjen procedurale ku ndodhet procedura e kontrollit dhe verifikimit të kandidatës Valbona Bala (Pajo), në zbatim të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, si edhe të pikës 30 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, meqenëse sipas vlerësimit paraprak *rezultojnë gjetje të cilat mund të sjellin ndalimin e kandidimit*, anëtarja relatores e Këshillit znj. Vitore Tusha ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

32. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 30.07.2019, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të znj.Valbona Bala (Pajo), për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

33. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidates Valbona Bala.

34. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

35. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 30.07.2019, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

36. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

37. Në thelb, Avokati i Popullit parashtrroi se, në rastin konkret, KPK dhe KPA ka vendosur ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar dhe vendosjen e ndalimeve të parashikuara nga Neni 6 i Aneksit të Kushtetutës për tu emëruar gjyqtar e prokuror në çdo shkallë të sistemit, anëtar i KLGj dhe KLP, Inspektor i Lartë i Drejtësisë dhe Prokuror i Përgjithshëm. Kemi qëndrimin se është rasti që KED të vendosë një standard dhe të shqyrtojë nëse është i tillë që të përbëjë ndalim në kuptim të procedurave përzgjedhëse të KED. Shkaku i ndërprerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar nga KPK është marrja prej saj e një pozicioni si eksperte pranë misionit OPDAT, për shkak të njohurive të saj të posaçme. Për Avokatin e Popullit, marrja e një detyre tjetër, të ndryshme nga ajo e këshilltarit të Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të jetë në asnjë rast njësoj e dënueshme/sanksionueshme si rastet e subjekteve të rivlerësimit që gjenden në shkelje të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, kjo kandidate kandidon tashmë si një individ jashtë sistemit. Prandaj është vendi të aplikohet nocioni i proporcionalitetit, të paktën në lidhje me këtë fazë të aplikimit ose për këtë shkak të relatuar si gjetje që mund të sjellë ndalimin e kandidimit. Po kështu, ka një paqartësi nëse në këtë sanksion të dhënë nga KPA përfshihet apo jo ndalimi për të pasur një pozicion në Gjykatën Kushtetuese sepse kjo gjykatë nuk është pjesë e sistemit gjyqësor. Askush nuk mund të penalizohet me një sanksion që nuk është shprehimisht i parashikuar në ligj. Në përfundim, mendojmë se, vetëm për këtë gjetje, nuk jemi në kushtet e ndalimit të kandidimit dhe ajo do të duhet të vlerësohet së bashku me gjetje të tjera në procedurën e verifikimit.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

38. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatës, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndalimin e kandidimit të kandidatës Valbona Bala (Pajo) për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

39. Për sa i përket procedurës së verifikimit të plotësisimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi mban parasysh që me vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit (JR) nr. 17 datë 25.07.2019 është vendosur që *subjekti i rivlerësimit Valbona Bala (Pajo) nuk mund të emërohet gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15 vjeçare.* Ky vendim i Kolegjit të Posaçëm të Apelit është përfundimtar dhe i formës së prerë.

40. Në nenin G të Aneksit të Kushtetutës parashikohet se:

“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet.

2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.”.

41. Kjo dispozitë kushtetuese nuk e përmban në mënyrë të shprehur apo të dallueshme ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit në funksionin kushtetues të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli mban parasysh që kjo dispozitë kushtetuese synon të adresojë shprehimisht ndalimin e kandidimit dhe emërimit në funksione gjyqësore, prokuroriale dhe të kontrollit e të administrimit të sistemit gjyqësor e të prokurorisë.

42. Por, nga ana tjetër, ky parashikim nuk përjashton mundësinë dhe raste të tjera kur, me anë të ligjeve të nxjerra në pajtim me Kushtetutën, mund të zgjerohet rrethi i funksioneve publike për të cilat mund të shtrihet ky lloj ndalimi. Në lidhje edhe me rastin konkret në shqyrtim, Këshilli vlerëson të evidentojë se neni 7/a i ligjit nr. 8577/2000 përmban kushte dhe kriterë ligjore rigorozë për lejimin e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Ndërmjet të tjera aty parashikohet se kandidati duhet të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit, të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral etj.

43. Këto kushte kandidimi, ndonëse kanë natyrë të përhershme, për rrethin e subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit kalimtar sipas nenit 179/b dhe Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, mund të pranohen të përmbushura nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vetëm nëse kandidati për gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese i është nënshtuar procedurave të verifikimit dhe të kontrollit nga organet e rivlerësimit kalimtar dhe ka një vendim konfirmimi në detyrë.

44. Nëse kandidati, i cili njëkohësisht është subjekt rivlerësimi, dorëhiqet nga detyra dhe ky vullnet konfirmohet nga organet e rivlerësimit kalimtar, ndodhet në kushtet që nuk i është nënshtuar kontrollit të detyrueshëm dhe vendimmarrjes nga organet e rivlerësimit kalimtar sipas Kushtetutës e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, duke qenë se Kushtetuta dhe ligji i

posaçëm i kanë dhënë përparësi organeve të rivlerësimit kalimtar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk mund të zëvendësojë apo përmbushë kompetencat që kanë ekskluzivisht organet e rivlerësimit kalimtar, pra nuk mund të vijojë me procedurat e tij të verifikimit dhe të disponimit mbi plotësimin ose jo të kushteve ligjore të kandidimit lidhur me verifikimin e pasurisë, aftësisë profesionale dhe integritetit etik e moral të atyre kandidatëve që janë subjekte rivlerësimi apo kanë qenë të tillë, por janë dorëhequr nga funksioni, duke iu ndërprerë procesi i rivlerësimit në zbatim të Nenit G të Kushtetutës me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar.

45. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidates, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, duke qenë se në zbatim të Nenit G të Kushtetutës, me vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit (JR) nr. 17 datë 25.07.2019, është vendosur ndërprerja e procesit të rivlerësimit për subjektin e vlerësimit Valbona Bala (Pajo), Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset edhe ndërprerja e procedurave të tij të verifikimit dhe të vendoset ndalimi i kandidimit të kandidates Valbona Bala (Pajo) për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës dhe të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, të neneve 7/a dhe 7/c të ligjit nr. 8577/200, të pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të shkronjës “b” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidates Valbona Bala (Pajo), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidates Valbona Bala (Pajo).
3. Kandidatja Valbona Bala (Pajo) ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

Ardian DVORANI

